

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, bazuar në nenin 28 dhe nenin 19 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut 208/24), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Shoqëria Aksionare e Brokerimit të Sigurimeve VFP SH.A., me seli në bul. Koço Racin nr. 3 hyrja 2 kati 2 Shkup - Qendër, Republika e Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 17.12.2024, mori këtë

AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin Shoqëria Aksionare e Brokerimit të Sigurimeve VFP SH.A. Shkup me seli në bul. Koço Racin nr. 3 hyrja 2 kati 2 Shkup - Qendër, Republika e Maqedonisë së Veriut, do të fitojë 50.01% të aksioneve në Shtëpinë Brokere INOVO BROKER SHA Shkup, me seli në bul. Teodosij Gologanov nr. 60-1 kati 2 Shkup - Qendër, Republika e Maqedonisë së Veriut, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2.Parashtruesi i njoftimit për përqendrim detyrohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6,000.00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30,000.00 denarë, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 10000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

A r s y e t i m

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më 21.11.2024, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) ka pranuar një njoftim për përqendrim nga Shoqëria Aksionare e Brokerimit të Sigurimeve VFP SH.A. Shkup, me seli në bul. Koço Racin nr. 3 hyrja 2 kati 2 Shkup, me të cilin VFP SHA Shkup do të fitojë 50.01% të aksioneve në Shtëpinë Brokere INOVO BROKER SHA Shkup, me seli në bul. Teodosij Gologanov nr. 60-1 kati 2 Shkup - Qendër, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit me ditën e pranimit të tij dhe bazuar në të dhënat e dorëzuara në njoftimin për përqendrim dhe shtojcat e tij konstatoi sa vijon:

Aktivitetet kryesore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

-Shoqëria Aksionare e Brokerimit të Sigurimeve VFP SH.A. Shkup është pjesë e grupit për këshillim financiar WVP Group nga Graci, Republika e Austrisë. Grupi VFP është pionier në fushën e shërbimeve të avancuara financiare, i përfaqësuar në hapësirën e Evropës Qendrore dhe Juglindore. Grupi është themeluar në vitin 1985, në Grac, Republika e Austrisë. Veprimtaria prioritare e Grupit VFP është ndërmjetësimi dhe shitja e produkteve të sigurimeve dhe financiare në 15 vende në Evropën Qendrore dhe Juglindore për më shumë se 30 vjet. Grupi, përveç në R. e Austrisë, është i pranishëm përmes personave juridikë edhe në R. e Bosnjës dhe Hercegovinës, R. e Bullgarisë, R. e Kroacisë, R. e Ukrainës, R. e Moldavisë, R. e Serbisë, R. e Malit të Zi, R. e Shqipërisë, si dhe R. e Maqedonisë së Veriut.

- Shoqëria Aksionare e Brokerimit të Sigurimeve VFP SH.A. Shkup është një nga personat juridikë që janë pjesë e Grupit VFP. Është themeluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut më 16.05.2005 dhe në përputhje me dispozitat ligjore posedon licencë për kryerjen e veprimtarisë nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Aksionari më i madh i kompanisë VFP SHA Shkup është WVP-Versicherungs-Vermittlungs-Ges.m.b.H, R. e Austrisë, e cila zotëron 77.85% të aksioneve të VFP SHA Shkup. Veprimtaria kryesore e kompanisë është e lidhur me aktivitetet e përfaqësuesve në sigurime dhe ndërmjetësuesve të sigurimeve në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

-Shtëpia Brokere INOVO BROKER SHA Shkup është anëtare e Bursës së Maqedonisë SHA Shkup dhe e Depozitarit Qendror të Letrave me Vlerë SHA Shkup. Është themeluar më 24.10.2005 dhe është e autorizuar për tregtimin e letrave me vlerë në Bursën e Maqedonisë. Veprimtaria prioritare e INOVO BROKER janë aktivitetet e ndërmjetësimit në punën me letra me vlerë dhe kontratat e mallrave. INOVO BROKER kryen punë të blerjes dhe shitjes së letrave me vlerë sipas urdhrit dhe për llogarinë e klientëve, vepron si sponsor në kuotime, merret me këshillim investues, si dhe pranimin dhe transmetimin e urdhrave për blerjen dhe shitjen e letrave me vlerë në tregjet e huaja të letrave me vlerë.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi që i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit dhe pikën 6 c) i) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin pasi që nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij vendimi mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të tij.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Ана Николоска